



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN

Nr. / Br. 18265/25

Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data: / Datum: 28.04.25

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 71/25 28/04/2025

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 49/23 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë –OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim të datës 23.02.2023, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **24 prill 2025** merr këtë:


V E N D I M
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

1. Me këtë vendim znj. Ferdane Shala, nga fshati Stanoc i Epërm i ndahen mjete financiare në shumë prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €), ndihmë financiare
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, kategoria subvencione dhe transfere, kodi 730 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 72/25 28/04/2025

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **24 prill 2025** merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për dëshmorin Avni Saraçi

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për dëshmorin Avni Saraçi, në sipërfaqe prej 65 m², pjesë nga parcela P-700202016-00001-1, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa me shkrim, projekti për ndërtimin e bustit, lista poseduese e pronës dhe kopja e planit.
5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPÇTINA VUÇITRN
Nr./Bx. 18274/25
- 1 -
Nr. i Gj./Rr. sh.
Data: / Datumi: 28.04.25
VUSHTRRI-VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 73/25 28/04/2025

Bazuar në nenin 6, të Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 19, paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **24 prill 2025** merr këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. NR.59/25, BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit Nr.59/25 i datës 27.03.2025 për **bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025**, nga të hyrat e bartura në kategoritë si në vijim:

1.1 Ndryshimi bëhet te kategoria Mallra dhe shërbimet nga shuma **78,991.29** bëhet **77,200.29 €**, (vlera financiare e ndryshuar është **1,791.00 €**).

1.2 Investime kapitale.....930,772.00 €

Totali i mjeteve të bartura.....1,007,972.29 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale, të cilat mbesin të pandryshuara, përjashtuar ndryshimin në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

